



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**KUVENDI KOMUNAL PEJË**

**Komiteti për Politikë e Financa**

**I.Numër: 060/01-14744**

**Pejë, datë: 18 mars 2025**

**PROCESVERBAL**

Nga takimi i I-rë i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me **18 mars 2026**, në orën 11:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, DKRS znj.Xhenet Syka, DUMM znj.Arta Nallbani, ZKF znj.Hajrije Haxhijaj, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, z. Avni Gashi, zyrtare administrative znj. Donjeta Morina, dhe përfaqësuesit e OSCE-së dhe ZIP-it

Takimin e hapi dhe e udhëhoqi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili hapi diskutimin për rendin e ditës, dhe i sqaroi të gjitha pikat të cilat janë vendosur në rend ditë. Po ashtu e cekti se pika 5 tërhiqet nga rendi i ditës dhe shtohet pika 12. Po ashtu sqaroi për anëtarët e rinje që KPF është një trup ndihmës që shqyrton paraprakisht materialet për seancën e kuvendit. Gjithashtu gjatë këtij takimi anëtarët e rinje mund të japin kontributin e tyre në sugjerimin e tyre në plotësimin e materialeve. Po ashtu pikat që janë për kuvend komiteti i aprovon, i rekomandon kuvendit, por nuk mund ti ndal pikat në takimim e KPF-së.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent u miratua ky rend dite,

## Rendi i Ditës

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 17.09.2025.
3. Shqyrtimi dhe rekomandimi i Planit të Punës së KKSB-së për 2026.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi për formimin e komisionit për hartimin e Draft Statutit të Komunës së Pejës.
5. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit për formimin e komisionit për ndryshim plotësimin e rregullores së Këshillave Lokale në Komunën e Pejës.
6. Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Drejtorisë së Arsimit Pejë për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv. Drejtorëve të institucioneve publike edukativo-arsimore në Komunën e Pejës.
7. Shqyrtimi i informatës mbi procesin e legalizimit të objekteve në Komunën e Pejës.
8. Shqyrtimi i raportit monitorues për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nga PZHK, PU dhe PRR për vitin paraprak.
9. Shqyrtimi i raportit final financiar të Komunës së Pejës për vitin 2025.
10. Shqyrtimi i informatës mbi ndarjen e subvencioneve për vitin paraprak dhe plani për ndarjen e tyre për vitin 2026.
11. Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës së Zyrës për Komunitete mbi procesin e kthimit dhe riatdhesimit për vitin paraprak dhe Planit të Zyrës për Komunitete për 2026.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i Nismës për bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Pejës nga Republika e Kosovës dhe Komunës së Kolobrzeg nga Republika e Polonisë.
13. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar:

### **2.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.**

Nuk ka pasur.

### **3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të KPF-së dt. 17.09.2025.**

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, mirtohet procesverbali i dt.17.09.2025.

#### **4.Shqyrtimi dhe rekomandimi i Planit të Punës së KKSB-së për 2026.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: plani i punës ju është përcjellë me material dhe janë caktuar anëtarët e rinj të komisionit për KKSB. Është një plan i KKSB-së për takimet që janë parapa për vitin 2026 dhe gjithashtu edhe çështjet kryesore që janë për diskutim.

Z.Labinot Panxha: unë mendoj se në secilën pikë të rendit të dites do të duhej të ishin ata të cilët i përfaqësojnë, në këtë rast nënkryetari i komunës si kordinator i këtij plani. Do të duhet të ishte këtu dhe të na prezentonte këtë pikë të rendit të ditës. Në qoftëse i kemi tre drejtor të cilët i kanë 3 pika të rendit të dites i bjen që keta e kanë respektu këtë trup ndihmëse të cilën ju folët më heret, e cila është shumë e rëndësishme. Në qoftëse këta drejtor nuk vin dhe nuk prezentojnë planin e tyre, mendoj që ne nuk duhet me pas respekt dhe as me j'u respektu, as me i votu pikat të cilat i kanë sjellë këtu!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro,4 anëtar nuk marrin pjesë për votim, i rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

#### **5.Shqyrtimi dhe rekomandimi për formimin e komisionit për hartimin e Draft Statutit të Komunës së Pejës.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: për ndryshimin e Draft Statutit duhet të formohet një komision nga kuvendi dhe nga diskutimi publik. Komisioni përbëhet prej 9 anëtarëve, 2 anëtar nga kryetari Afrim Shala dhe Avni Gashi, 6 anëtar nga kuvendi dhe 1 anëtar nga shoqëria civile.

Z.Ardit Berisha: për këtë pikë të rendit të dites duhet të dihet pak a shumë se çka do të ndryshohet për hartimin e Draft Statutit të Komunës, sepse është akti më i lartë nënligjor i Kuvendit komunal. Në material nuk kemi pranë diqka lidhur me këtë çështje, vetëm rekomandimin e kryetarit për formimin e këtij komisioni. Nëse ka mundësi të kemi një informacion me të detajuar.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ndoshta dikush nga ekzekutivi duhet të ishte prezent pasi nuk kemi pasur ndonjë material. Por e di që ky komision e ka për qëllim ndarjen e digastereve dhe drejtorive të reja dhe departamenteve brenda në drejtorin me këtë statut. Pastaj komisioni i formuar e mer planin e detajuar komplet nga kryetari, pastaj vihet në diskutim publik dhe në vazhdim procedurat tjera.

Z.Naim Bytyqi: pajtohem me kolegun që duhet informacion për shkak se në këto çështje këtu i bartim edhe te koleget tjerë dhe gjatë seancës së kuvendit duhet me qenë me të qartë për gjitha pikat. Andaj deshta të pyes se në komision a marrin pjesë subjektet politike ?

Xhenet Syka: në kuvend kanë me sqaru detajshin sepse këtu e kemi vetëm propozimin e kryetarit.

Z.Avni Gashi: marrin pjesë një anëtar nga secili subjekt!

Ardit Berisha: e kuptoj që pa pjesëmarrje e opozitarëve nuk mund të ndryshohet statuti sepse kërkohet korumi i kuvendit. Po ashtu ne nuk kemi kurfar material dhe nuk dim qka votojmë! Unë propozoj me u shty kjo pikë e rendit të dites derisa të na sjellin një material i cili prezenton planin e ndryshimit të Statutit e atëhere të votojmë ose jo.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ju sqarova edhe më heret që pasi të formohet komisioni, fillimishtë e kanë materialin dhe pastaj duhet me sjellë në diskutim publik. Komplet material është i hapur një muaj për qytetarë dhe anëtarët e kuvendit për sugjerimet ose vërjetjet e tyre.

Z.Bekim Morina: unë mendoj që më së miri pasi që jemi trupa mbështetëse e kuvendit të rekomandojmë për kuvend, pastaj të kërkohet që në kuvend të vjen material dhe të paraqitet një dokument i kompletuar dhe me baza të cila kërkohet se pse duhet të ndryshohet ky statut!

Z.Tahir Shala: kjo ka ardh si rrjedhojë nga dinamikat e komunës që nga miratimi i statudit të fundit 2008, dhe kjo ka ardh në bazë të kërkesave të ekzekutivit të cilat janë parqit. Nuk ka material pasi që komisioni i formuar do të punoj në këtë drejtim dhe po ashtu është angazhuar edhe një ekspert i jashtëm.

Znj.Xhenet Syka: pika e rendit dites sot është vetem informatë, njoftim që po fillon një proces i ri dhe duhet me dite edhe KPF-ja. Pastaj ka me u mbledh material, kanë me u mbajt dëgjimet publike, dhe komisioni ka me raportu para asamblesë është vetem nisma në formë propozimi.

Z.Ardit Berisha: unë po e kuptoj drejtoreshen edhe drejtorin po ne jemi duke folur për ndryshimin e Statutit të Komunës së Pejës. Këtë Statut nuk mundeni me ndryshu vet, nese po doni me ndryshu Statutin duhet me dit qka doni me ndryshu? Cili është plani? Jemi komision i rëndësishëm si trup mbështetëse e kuvendit komunal që duhet me dit se qka po doni me bo. Unë mendoj që ne për me ndihmu procesin duhet me tërheq këtë pikë dhe me sjellë në takimin tjetër dhe mu diskutu se cili është plani i komunës për ndryshimin e Statutit.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: unë e ceka edhe në fillim që komisioni i formuar ka me pas materialin komplet dhe ka me qenë i prezentuar në kuvend.

Z.Labinot Panxha: vet fakti që po thotë që ka me u formu komisioni për hartimin e Draft Statutit të Komunës, kjo po nënkupton që ky Statut ka me u ndryshu. Kur formohet pastaj ky komision i gjitha partive e kanë për obligim me bo këtë Draft –Statut. Nuk mundesh me j'a sjellë komisionit Draft-Statutin dhe me i thonë voto, sepse ky komision nuk ka me qenë ai që ka me i bo keto ndryshime. Pastaj e dyta nese ndryshohet krejt statuti atëhere të gjitha aktet nënligjore të cilat janë të bazuara në Statutin e vjetër duhet të gjitha të ndryshohen. Ndërsa kur vim tek Statuti i ndryshuar qarkullojnë shumë fjalë që kanë me u nda drejtoritë, dhe kanë me u shtu drejtoritë. A jemi të përgatitur ne si komunë? A jeni të përgatitur ju si ekzekutiv? A keni buxhet për ato drejtori që keni me i shtu? Apo keni me ju nda drejtorive tjera, keto e shumë çka tjetër! Përndryshe unë po e kuptoj që sot ka ardh informate për formimin e komisionit pastaj vin procedurat tjera.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 3 anëtar të përmbajtur, 1 anëtar nuk ka marr pjesë në votim, rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

#### **6.Shqyrtimi dhe rekomandimi i propozimit të Drejtorisë së Arsimit Pejë për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv. Drejtorëve të institucioneve publike edukativo-arsimore në Komunën e Pejës.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: drejtori i ka do emra që janë të caktuar për komision e zgjedhjes së drejtorëve të shkollave dy emra të propozuar nga drejtoria dhe një nga ministria.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk marrin pjesë në votim, rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

#### **7.Shqyrtimi i informatës mbi procesin e legalizimit të objekteve në Komunën e Pejës.**

Znj.Arta Nallbani: po besoj që edhe një email e keni krejt informatën e procesit të legalizimit për vitin 2025. Drejtorja jonë është mundu që në pika të shkurta të përfshij gjithë procesin e legalizimit e cila rregullohet me ligjin për trajtimin e objekteve pa leje, të cilat përfshihen krejt objektet të ndërtuara pa leje ose para dates 5 shtator të vitit 2018. Përveq informatave mbi procesin e legalizimit, paraqitjen e dokumentacioneve dhe gjithë procedurave tjera që duhet qytetari me i paraqit në drejtorinë DUMM, kam paraqitur edhe numrin e kërkesave të cilat janë pajisur me çertifikatën e legalizimit dhe kanë shkuar për regjistrim në Kadaster dhe RDPP. Gjatë vitit 2025 DUMM ka pranuar gjithsejt 377 kërkesa për legalizimin e objekteve/ndërtimeve pa leje. Ku prej këtyre kërkesave 152 kanë përfunduar dhe janë pajisur me Certifikatën e Legalizimit e poashtu edhe janë dërguar në Drejtorinë për Kadaster për regjistrim në Regjistrin për të Drejtat në Pronën e Paluajtshme (RDPP). Pjesa tjetër e kërkesave është përfshirë në Listën e Pritjes pasi që konstatohet se ndërtimi në fjalë nuk kualifikohet për të vazhduar me procedurat për certifikatë të legalizimit. Po ashtu i kanë paraqitur disa prej sfidave të cilat drejtorja jonë përballet se pse ato objekte apo ndërtime pa leje nuk kanë mujt me u pajis me çertifikatë të legalizimit ku ndër to janë: objektet që janë ndërtu pas datës 05.09.2018, janë ndërtu në prona komunale, prona shoqërore apo në prona ku gjenden monumentet e mbrojtura etj.

Z.Labinot Panxha: ne e dim se kush ka qeveris prej vitit 2016 e deri me sot! Janë partia në pushtet dhe koalicioni në pushtet të cilët si duket nuk e kanë kry punën mirë. Kanë leju me u ndërtu objekte pa leje, kanë leju me ndërtu objekte vend e pa vend të cilat edhe i përmendi drejtoresha. Unë mendoj që legalizimi i këtyre objekteve i hap rrugë njerëzve tjerë për të ndërtu pa leje, sepse ata e din qe mbas 5-6 vjetëve kanë me i legalizu. Kjo jo vetem që e shëmton qytetin por edhe e dëmton buxhetin edhe qytetarin, dhe është një sinjal i keq për komunën tonë. Në vend që të ketë inspektor te dalin në teren dhe ti parandalojnë ndërtimet pa leje, neve na vjen një material që duhet me i legalizu ato ndërtesa apo objekte qe janë ndërtu para 5 ose 6 vjet më heret e i cili ka qenë pushteti i njejt, e njejt parti dhe e njejt legjislaturë. Unë edhe këtu i bëj thirrje krejt anëtarve që e dojnë qytetin që mos t'i votojnë këto legalizime, dhe bëj thirrje që të

shkojnë të njëjta të rënohen. Kjo do të quhet nderëshmëri dhe punë të cilët kemi na obligim ndaj qytetarëve tonë.

Z.Ardit Berisha: e kam një pyetje për drejtoreshen sa ndërtime pa leje janë në vitin 2025, si informacion pastaj me vazhdu diskutimin?

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: sipas rregullores anëtari ka drejte 10 minuta me diskutu rreth materialit ndërsa repliken 3 min, pasi bëhet debat interaktiv mes dy personave dhe mandej e hupin mundësin me fol anëtarët e tjerë që janë pjesë e takimit.

Z.Naim Bytyqi: deshta me u ndal tek ndërtimet në prona ku gjenden monumentet kultërore ose arkiologjike siq tha drejtoresha, qaty ish dasht me marr për bazë dhe me rënu ndërtime ku pengojnë. Kemi një rast tjetër tek ish Fabrika e Baterive dhe ndoshta kjo nuk është në këtë list, mirëpo këto ndërtime pa leje ku prekin kulturen, arkiologjinë mu bo pjesë e rënimit ose ndryshimit.

Znj.Arta Nallbani: po filloj nga pyetja e Labinotit, ku tha që Ligji për legalizim apo tratimin e objekteve pa leje nuk është po e them bufalishtë ligj i mirë dhe po ju jep hapsirë që prap investitorët me vazhdu me bo ndërtime pa leje apo jam gabim?

Z.Labinot Panxha: jo gabim, nuk thash që Ligji për legalizim është i keq, por po them që në qoftëse një qytetarë në vitin 2018 ka ndërtu pa leje, unë mendoj që kjo është keqmenxhim. Sepse nese shkoj unë dhe ndërtoj pa leje me mendimin që pas 5 viteve ka me mu legalizu sepse ligji ma jep këtë mundësi, pse po më lejon ti me ndërtu pa leje?

Znj.Arta Nallbani: e kam të qartë që i bjen që po ju jep komoditet që me vazhdu me ndërtu sepse e din që ka me ju legalizu ose ka me ju fal qaj ndërtim. Vetem për dijeni që Ligjin për Legalizim nuk e formon asnjë komunë, na vjen prej qeverisë ose më saktë nga Minisitria e Infrastruktures dhe Planifikimit Hapsinor. Për gjatë qeverisjes time për 4 vite nuk jemi ftuar asnjëhere ne si komunë në qfarëdo komisioni për hartimin e ketij ligji.

Z.Labinot Panxha: drejtoreshë nuk e thash as këtë! Unë thash që me zbatu ligjin dhe mos me shku me ndërtu dikush pa leje. A ka ligj që thotë shko ndërto pa leje?

Znj.Arta Nallbani: unë jam drejtoreshë e urbanizmit dhe nuk jam drejtoreshë e inspektionit unë jap raporte sa leje të ndërtimit janë lëshu dhe sa legalizime janë bë. Tutje me procesin e implementimin se qysh janë ndërtu ato ose a ka ndërtime pa leje, sa është nr i ndërtimeve pa leje është drejtoria për punë inspektuse që është drejtor dikush tjetër. Ndërsa Ligji për trajtimin e objekteve pa leje miratohet në qeveri dhe hartohet prej Ministrisë së Infrastruktures dhe Planifikimit Hapsinor. Komuna në këtë rast është vetem organi që e zbaton dhe implementon atë ligj. Po ashtu harrova me ceke se ligjit për trajtimin e objekteve pa leje i ka skadu afati dhe me vendimin e qeverisë është shty edhe per 12 muaj me të njëjta kritere. Ndërsa sa i perket numrit të ndërtimeve pa leje, dhe më heret thash që jam drejtoreshë e urbanizmit jo për punë inspektuse

por besoj që këtë raport e ka drejtori i ri tash për punë inspektuese. Sa i perket pjesës që e cekim Naimi për pjeset e monumentet të mbrojtura unë i ceka objektet që janë ndërtu më heret dhe që hyn në procesin e legalizimit. Unë thash që ndalohen objektet që janë të ndërtuara në pjesen e monumenteve të mbrojtura është kriter prej ligjit 06/L-24 të miratim në qeveri. Komuna veq e zbaton i implementon këto kritere dhe përfshihen në listen e pritjes derisa qeveria mer vendim se çka me bo tutje!

Z.Ardit Berisha: drejtoreshë ju e dini shumë mirë sa i keni 225 ndërtime pa leje përderisa i keni pas 375 kërkesa. Prej tyre 152 e kanë mar certifikaten e legalizimit dhe 225 nuk i kanë kanë përmbush kushtet për legalizim që automatikisht kalojnë në ndërtime pa leje. Raportin të cilin ju e keni dërgu është raport qesharak! Për shkak se asnjë informacion nuk e ke dhënë lidhur me saktësin e këtyre ndërtimeve apo objektet që janë ndërtu pa leje. Raportin e ke nda në dy pjesë por asnjë shifer statistikore nuk e ki jep se sa ndërtime janë që nuk e posedojnë certifikaten e pronësisë, sa nuk e kanë dokumentacionin e nevojshme që e dëshmon të drejten e tij si pronar i ndërtimit pa leje ,sa janë prona shoqërore, sa janë prona publike, sa janë toka bujqësore etje. Për shkak që nuk e kam të qartë dhe po të kërkoj sqarime shitesë, po them qe na duhet një raport më i detajuar. Andaj mos i ikë pyetjes drejtoreshë për shkak se ju e dini shumë mirë se sa kërkesa i keni aprovu, dhe sa kërkesa nuk i keni aprovu.

Z.Tahir Shala: unë po filloj prej shtëpise teme qe e kam në Baran në tokë bujqësore dhe afer monumentit kulturorë edhe krejt në fshatra jemi pa leje. Duhet me mar kontekstin se qysh është zhvillu shoqëria jonë, dhe nuk mundesh me thonë që 20 vjet nuk është bo kurgjo në këtë vend. Nuk janë këto objekte që janë ndërtu në qeverinë tonë, por janë objekte që gjysa e qytetit që janë ndërtu e kanë pas emërgjenca të ndryshme dhe janë ardh deri këtu! Në Kosovë janë 30 mijë objekte pa leje spo thom që janë të arsyshme, por qysh o zhvillu shoqëria jonë 99.9% janë objekte që janë ndërtu me arsye të ndryshme.

Z.Labinot Panxha: deri në vitin 2000 nuk i heki as pike as presje se çka tha Tahiri! Po sot po flasim prej vitit 2018 e deri me sot. Tash një pyetje për drejtoreshen se u mundova shumë here me ja shpjegu sa ka ndërtime pa leje prej 2018 e deri me sot ? Një shembull i keq që e përcjellin qytetarët se thojnë ka me u legalizu kudo që ndërtojmë. Psh po ta jepi një shembull unë si qytetarë i komunës po du me ndërtu në Asllan Qeshme një shtëpi dhe kom me ju drejtu drejtorisë përkatëse dhe kam me kërku lejen për me ndërtu, yetja e thjeshtë është se ne çka bazohna unë ose në çka bazohet komuna që ma lëshon mu qat leje? Një ligj ma ndalon mu që unë me ndërtu pa leje vetem të respektojmë ligjin për të cilin po flas unë, e legalizimin nuk mundem me bo mbas 5 ose 6 vjete qekjo ke përmbledhja!

Znj.Arta Nallbani: komuna e Pejës operon me harta zonale e cila është miratu me 28.12.2023. Harta zonale e Pejës është një plan i detajuar që specifikon krejt parcelat, vendbanimet dhe destinimet në zona të caktuara se ku ty të lejohet me ndërtu, po ashtu parasheh edhe zhvillimin e komunës për 8 vitet e ardhshme që i bjen deri në vitin 2031, e cila është shumë saktë e detajuar se çka lejohet dhe çka nuk lejohet. Drejtorja e urbanizmit dhe zyrtarët brenda saj operojnë që të

lëshojnë leje të ndëritimit duke u bazuar në hartën zonale të komunës së Pejës, në Planin Zhvillimor Komunal dhe në dokumentacionet tjera përcjellëse dhe ligjet për planifikim hapsinor të cilët thirren për me lëshu lejet e ndëritimit. Ndërsa sa i përket inspektimit të ndëritimit është drejtorja për punë inspektuese që e bën inspektimin se a është duke ndërtu më shumë! Ne nuk kemi qasje dhe inspektori nuk më raporton se sa ndërtime pa leje janë apo sa punë i ka ndal. Kjo është një informata e përgjithëshme që i kam specifikisht qartë se cilat janë kërkesat, sfidat etj.

Z.Ardit Berisha: unë vetëm j'a bëra një pyetje të thjeshtë drejtoreshes që nuk ke në gjendje me mu përgjigjë sa kërkesa nuk i ka aprovu, sa kërkesa nuk janë legalizuar nuk e ki informacionin bazik. Unë po flas nga prespektiva e juristit se nese ti i ki 377 kërkesa për legalizim dhe i ke lëshu vetëm 152 aprovime, 225 nuk i ke legalizuar. Pse nuk janë legalizuar? I bjen që janë ndërtime pa leje. Nuk ke sjellë raport të detajuar siq e ceka me lartë, nuk jena duke folur për aspektin historik po flasim për vitin 2025, e vetëm në vitin 2025 i ke 225 ndërtime pa leje sipas këtij informacioni.

Znj.Arta Nallbani: kërkesat e vitit 2025 janë 377 kërkesa, po lista e pritjes është edhe para se me qenë drejtoreshë unë, por nese keni një pyetje specifike mundem me kqyr dhe me gjet për asamble komunale por pyetje të përgjithëshme nuk kam shanca sepse kanë probleme të llojllojshme.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk marrin pjesë në votim, rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

#### **8.Shqyrtimi i raportit monitorues për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nga PZHK, PU dhe PRR për vitin paraprak.**

Znj.Arta Nallbani: është një informata e raportit monitorues për krejt projektet që janë parapa në PZHK dhe në HZ. Kjo nuk është bërë prej drejtorisë tonë por në kordinim me krejt drejtoritë tjera të komunës dhe me zyren e kryetarit. Pasi që është një raport shumë voluminoz dhe ka shumë projekte nese ka dikush diqka për sqarim jam ktu për diskutim.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk marrin pjesë në votim, rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

#### **9.Shqyrtimi i raportit final financiar të Komunës së Pejës për vitin 2025.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: në lidhje me këtë raport e keni mar një material, nese ka dikush diqka për diskutim e kemi prezent edhe ZKF Hajrije Haxhijaj.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 5 votë pro, 4 anëtar nuk marrin pjesë në votim, rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

## **10.Shqyrtimi i informatës mbi ndarjen e subvencioneve për vitin paraprak dhe plani për ndarjen e tyre për vitin 2026.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: materialin e keni mar nese ka dikush diqka për diskutim drejtorin e kemi prezent për sqarim shtesë.

Z.Labinot Panxha: në vitin 2025 drejtoria për bujqësi paska ndihmuar fermer me paisje të ndryshme bujqësore, meqenëse Tahiri është prezent e kam një kërkesë që të gjitha subvencionet që ndahen mos të përseriten dhe me ju dhënë edhe njëhere një fermerit që e ka marr një here Të respektohet rregullorja dhe sado pak bën përpjekje me ju nda fermerve që e meritojnë, punojnë token dhe mos të marin dy e me shumë dhe dikush tjetër mos të mer asnjë. Edhe pse është një ndihmes e vogel kishte me qenë mirë me u dyfyshu! Mirëpo është më se e nevojshme subvencionimi i fermerve në komunën e Pejës.

Z.Ardit Berisha: pasi që e lexova raportin me ra në sy një pjesë ku thuhet që 5 kërkesa urgjente individuale janë ndar dhe janë trajtuar nga drejtoria për bujqesi. Një pyetje për drejtorinë se cilat kërkesa kanë qenë dhe pse janë përdor në mënyrë urgjente?

Z.Tahir Shala: po e nisi prej Labinotit te shuma që ka qenë vitin e kaluar 270 mijë euro dhe ktu duhet me j'a nis pak një histori pak më heret. Në vitin 2019 kanë qenë edhe investimet kapitale edhe subvencionet ke mujt me i perdor ku ki dasht, dmth kanë qen deri në 2 milionë euro subvencione sepse tu ka leju me i marr prej mallra dhe shpenzime. Pastaj qeveria na ka ndalu me një vendim dhe ka caktu në bazë të numrit të banorëve edhe subvencionet. Kur jam ardh unë drejtor ka qenë shuma 30 mijë vitin e parë, pastaj 270 mijë euro e në këtë mandat është shuma 500 mijë euro. Ndërsa në fund të mandati po besoj ka me shku shuma deri në 800 mijë euro po besoj sipas kornizes afatmesem buxhetore. Po ashtu për kërkesen që the mos me mar një fermer dy here, subvencionet i shpërndajme në bazë rregullures komunale që e ndalon që fermeri që ka marr vitin paraprak, këtë vitë diskualifikohet. Sa i perket pyetjes për kërkesa urgjente ne si drejtori e kemi një buxhet të ndam 20 mijë eurove për kërkesa urgjente dhe e kemi një komision që i shqyrton këto kërkesa urgjente. Çdo vitë e kemi auditorin e brendshem dhe të jashtem dhe deri tash nuk e kemi pas asnjë problem dhe besoj jemi transparent 99.9%.

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: për dallim nga drejtorati i bujqësisë, drejtorati DKRS vazhdon akoma edhe më shumë me i suportu të sukseshmitë. Nese një fermer subvencionohet dhe pret deri vitin tjetër, tek ne është e kundërta nese ke suksese në Arenen Botrore dhe Ndërkombëtare komuna obligohet akoma më teper me suportu. Unë, muj me ju njoftu deri në pikë të fundit sa kemi shpenzu vitit të kaluar tek DKRS, sepse kam fillu me u ballafaqu me disa pyetje se sa do t'i ndani sivjet? Sa i takojnë rinisë? Sa i takojnë kultures? Sa i takojnë sportit? Nuk mundeni në këtë fazë me u thënë sepse ne presim dhe në kuadër të thirrjes që të gjitha asociacionet me sjellë projekte. Dhe në bazë të projekteve dhe kërkesave të tyre, pastaj komisioni mundohet me bë një ndarje të barabartë, për arsye se i kemi disa klube shumë të suksesshme, kemi kampion olimpik, kemi klube që prezentojnë Pejën dhe Republikën e Kosovës jashtë vendit. Këtu ndoshta bëhet

një diskrepanzë në kosto por asnjëhere nuk bëhet diskrepanzë për kritere të tjera. Vetem tek sporti është një kriter shumë i rëndësishëm se varet gjatë vitit çfarë suksese ke arrit dhe çfarë sjellë si dëshmi të sukseseve. Po ashtu dhe një detaj duhna me ju njoftu që komuna e Pejës të gjitha aktivitetet sportive, kultërore dhe rinore i realizon me mjete të subvencioneve. Po ashtu e kemi të planifikuar edhe kodin e subvencioneve sa i perket bashkëpunimeve me donator ndërkombëtarë.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 6 votë pro, 3 anëtar nuk marrin pjesë në votim, rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

### **11.Shqyrtimi dhe rekomandimi i informatës së Zyrës për Komunitete mbi procesin e kthimit dhe riatdhesimit për vitin paraprak dhe Plani të Zyrës për Komunitete për 2026.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ju është përcjellë në material një raport sa i perket informatës nga Zyra për Komunitete, nese ka dikush diqka për diskutim nese jo e qesim ketë pikë për rekomandim në kuvend.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 8 votë pro, 1 anëtar nuk ka marr pjesë në votim, rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

### **12.Shqyrtimi dhe miratimi i Nismës për bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Pejës nga Republika e Kosovës dhe Komunës së Kolobrzeg nga Republika e Polonisë.**

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: në fakt në Planin Zhvillimor Komunal që është njëri nga dokumentet më të rëndësishme që prezenton komuna e Pejës, jo rasishtë janë zgjedhë si dy industri që premtojnë shumë, industria e turizmit të qëndrushëm dhe industria avanturie dhe shëndetësore. Janë bërë shumë punë tek turizmi i qëndrushem dhe duhet me i hap dyert me pranu miq ndërkombëtar, me bë vizita ndërkombëtare dhe mundësishtë që në kuadër të menagjimeve komunale me ja dal me i marr eksperiencat e mira nga vendet e ndryshme. Ju thashë edhe më heret që z.Drilon Gashi është ambasadorë kariere i cili punon në Warsaw, në kryeqytetin e Polonisë. Gjatë takimeve të vazhdushme me komitetin kosovar që e ka pas në Warsaw është prezentuar një kërkesë nga Ana Mieczkowska që është kryetare e komunës së Kolobrzeg në Poloni. Ideja e bashkëpunimit është shkëmbimi i përvojave turistike. Peja është lider absolut në turizmin e aventures në resursin natyror, dhe nga Kolobrezg mundohemi të nxjerimi formatet të zhvillimit të turizmit shëndetësorë duke pasur parasysh resursin e jashtëzakonshem të natyres që e kemi rreth Pejës.

Z.Ardit Berisha: lidhur me ketë çështje edhe ne si subjekt pajtohem i që të ketë sa ma shumë binjakëzime me komunat e vendeve Evropiane. Ne si subjekt pajtohem i që këto binjakzime të sjellin përfitime ekonomike, kultërore. Ne veqse turizmin shëndetësor e kemi pas në programin tonë si Lëvizje në Pejë. Kishte me qenë mirë që binjakzimet që i keni pas ma heret me i sjellë frytet qe i keni pas dhe të dim se a janë të sukseshme? A po dini me i përdor apo vetem për

konsum të brendshëm politik, edhe sa me shku me shetit dhe me i vizitu vendet, pastaj edhe ne normalishtë që i përkrahim.

Znj.Xhenet Syka Kelmendi: me vjen keq qe nuk qenke i informuar mire sepse tek faqja e DKRS –së mund të i gjesh të gjitha inofrmacionet karshi benefiteve, eksperiencave dhe programeve të përbashkëta kultërore.

Z.Ardit Berisha: unë i kemi përcjellë të gjitha binajkëzimet që i keni pas, dhe unë thash që i përkrahim dhe jemi pro binjakëzimeve nese sjellin rezultate. Kjo ke ajo se çfarë deshta të përcjellë!

Nga të gjithë anëtarët prezent me 7 votë pro, 2 anëtar nuk kanë marr pjesë në votim, rekomandohet kuvendit për shqyrtim.

### **12.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë renditje siç janë pranuar:**

Z.Ardit Berisha: tek kjo pikë e rendit të dites kisha dasht me ngrit një çështje! Kohët e fundit jam mar me çështjen e ambientit dhe gjëndjen e deponive të mbeturinave ilegale në Komunen e Pejës. Gjëndja është jo e mirë në aspektin e ambinetit dhe kam bisedu edhe me drejtorinë e sherbimeve publike për këtë çështje, po ashtu edhe kanalet e ujitjes janë të mbuluara me mbeturina! Unë veqse e kam edhe një liste të deponive ilegale në gjithë teritorinë e komunës së Pejës. Gjithësejt janë mbi 25 deponi ilegale të mbeturinave të lloj-llojshme, ato degradojnë edhe natyren edhe mjedisin edhe ujërat. Mendoj që komuna duhet me i trajtu këto deponi dhe me pas një plan se si duhet të kemi një qasje serioze të kësaj çështje. Në diskutimin që e kam pas me drejtorin me ka thënë që është mendu që me tenderim me largu kësto deponi. Mirëpo në planin e prokurimit për vitin 2026 nuk e kam pa një buxhet të ndam lidhur me këtë çështje. Andaj kërkoj nga ekzekutivi që kjo çështje të meret më seriozishtë edhe të jen më shumë në teren dhe të shohim se si mundemi me ju qas kësaj çështje!

*Pjesë e këtij procesverbali është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.*

**Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pat, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 11:40 h.**

**Procesmbajtësja,**  
**znj. Donjeta Morina**



